

VENDIM
Nr. 678, datë 10.11.2021

**PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, JOPUBLIK,
KOLEGJI PROFESIONAL I LARTË GJERMAN I TEKNOLOGJISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, 30 e 31, pika 1, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e institucionit të arsimit të lartë, jopublik, Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë, në emër të shoqërisë “Kolegji Profesional Gjerman i Teknologjisë” sh.p.k., i cili e ushtron veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë organizohet në 3 (tre) departamente, si më poshtë vijon:

- a) Departamenti i Mekanikës;
- b) Departamenti Elektrik dhe i Teknologjisë së Informacionit;
- c) Departamenti i Ndërtimit dhe Infrastrukturës.

3. Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë ofron programe të studimit sipas kuadrit ligjor në fuqi.

4. Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë e fillon veprimtarinë e tij vetëm pas nxjerrjes së urdhrit të ministrit përgjegjës për arsimin për fillimin e veprimtarisë.

5. Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional e të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

6. Statuti i institucionit të arsimit të lartë, jopublik, Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë, miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

7. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontroll periodik të ligjshmërisë në institucion, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe shoqëria “Kolegji Profesional Gjerman i Teknologjisë” sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama